

## TERMAT E REFERENCËS (ToR)

Shërbime Dizajni, Prodhimi dhe Mbështetje Komunikimi për Fushata Ndërgjegjësimi në kuadër të Projektit EAR-MHEWS

---

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Autoriteti Kontraktues

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)

Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Godina Nr. 36

Tiranë, Shqipëri

Personi i Kontaktit

info.ear-mhews@akmc.gov.al

Titulli i Projektit

Fuqizimi i Reziliencës së Shqipërisë përmes Bashkëzbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm për Shumë Rreziqe (EAR-MHEWS)

Vendi i Zbatimit të Detyrës

Shqipëri

Konteksti i vendit Shqipëria është e ekspozuar ndaj disa rreziqeve natyrore, përfshirë tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e dheut dhe fenomenet ekstreme të motit. Këto rreziqe ndikojnë ndjeshëm në infrastrukturë, ekonomi dhe komunitete.

Cenueshmëria e popullsisë ndikohet më tej nga faktorë mjedisorë, zhvillimi urban dhe niveli i kufizuar i ndërgjegjësimit publik mbi rreziqet nga fatkeqësitë. Forcimi i ndërgjegjësimit, gatishmërisë dhe kapaciteteve të reagimit përbën një prioritet kyç kombëtar.

Situata aktuale në sektor Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet institucioneve përkatëse, po zbaton iniciativa për forcimin e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë dhe rritjen e qëndrueshmërisë klimatike.

Një nga programet kryesore është “Climate Services for a Resilient Albania” (ALBAdapt), i cili synon përmirësimin e qëndrueshmërisë klimatike nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve klimatike dhe krijimit të një sistemi shumë-rrezikësh të paralajmërimit të hershëm (MHEWS).

Projekti EAR-MHEWS kontribuon në këtë përpjekje duke forcuar sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe duke promovuar ndërgjegjësimin dhe gatishmërinë e komuniteteve.

Aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit përbëjnë një komponent thelbësor të projektit, duke synuar publikun e gjerë, komunitetet lokale, institucionet dhe grupet vulnerabel.

## 2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME

## 2.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate është mbështetja e zbatimit të projektit EAR-MHEWS nëpërmjet dizajnit, zhvillimit dhe prodhimit të materialeve të komunikimit dhe ndërgjegjësimit.

Objektivat specifike

Objektivat specifike të kësaj kontrate janë:

- Të zhvillohen koncepte kreative dhe materiale vizuale për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të komunikimit, vizibilitetit dhe ndërgjegjësimit në kuadër të projektit “Forcimi i Qëndrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet bashkë-zbatimit të një Sistemi Kombëtar Shumë-Rrezikësh të Paralajmërimit të Hershëm (EAR-MHEWS)” në përputhje me objektivat e projektit dhe kërkesat për vizibilitet të partnerëve.
- Të prodhohen dhe dorëzohen produkte profesionale komunikimi në format print dhe dixhital, të cilat promovojnë ndërgjegjësimin publik mbi sistemet shumë-rrezikëshe të paralajmërimit të hershëm në nivel kombëtar dhe lokal.

## 3. FUSHËVEPRIMI I PUNËS

### 3.1 Të përgjithshme

Fusha e kësaj kontrate përfshin ofrimin e vazhdueshëm të dizajnit grafik dhe zhvillimit të përmbajtjes vizuale, si dhe prodhimin e materialeve të komunikimit dhe promovimit në mbështetje të aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të projektit EAR-MHEWS.

Kontraktori duhet të sigurojë që të gjitha produktet e komunikimit të jenë të përshtatshme për fushata të promovimit të projektit, ndërgjegjësimi publik në fushën e reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe gatishmërisë emergjente, si dhe të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të përshtatura për grupet e ndryshme të synuara.

Kontraktori do të jetë përgjegjës si për dizajnin, ashtu edhe për prodhimin (printimin dhe/ose prodhimin fizik) të materialeve. Prodhimi mund të realizohet drejtpërdrejt nga kontraktori ose nëpërmjet nënkontraktorëve apo partnerëve; megjithatë, kontraktori do të mbajë përgjegjësi të plotë për cilësinë, përputhshmërinë dhe dorëzimin në kohë të të gjitha rezultateve.

Të gjitha produktet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e vizibilitetit dhe identitetit vizual të partnerëve të projektit.

### 3.3 Detyrat specifike

Kontraktori duhet të:

- Zhvillojë koncepte vizuale, përmbajtje kreative dhe paketë dizajni komunikimi në përputhje me objektivat e projektit dhe rregullat për vizibilitetin;
- Hartojë një identitet vizual dhe sistem grafik të përcaktuar, përfshirë strukturat e layout-it, hierarkinë tipografike, logot, ikonat, asetet vizuale dhe elementet e branding-ut të fushatës në përputhje me udhëzimet, rregullat dhe kërkesat e projektit;
- Dizajnojë dhe prodhojë një set materialesh komunikimi dhe promovimi (print dhe dixhital), duke përfshirë por pa u kufizuar në broshura, postera, banera, materiale promovuese dhe përmbajtje për rrjetet sociale; (Siç është listuar në aneksin 2 të ToR)
- Dizajnojë dhe prodhojë materiale për evente si tenda, stenda promovuese etj.;
- Zhvillojë dhe prodhojë të paktën dy (2) video ilustruese ndërgjegjësuese, duke përfshirë zhvillimin e konceptit, storyboard, skriptimin bazë, kompozimin vizual dhe editimin final të përshtatshëm për fushata ndërgjegjësimi;
- Sigurojë zbatim të qëndrueshëm të udhëzimeve të branding-ut dhe komunikimit në të gjitha materialet;
- Përgatisë të gjitha materialet në formate të gatshme për printim, duke përfshirë specifikimet teknike (dimensionet, rezolucionin, profilet e ngjyrave, format grafik vektorialetj);
- Rishikojë dhe përshtasë materialet bazuar në komentet e Autoritetit Kontraktor;
- Dorëzojë të gjitha produktet finale, përfshirë file-t burimore të editueshme dhe formatet finale të gatshme për prodhim;
- Dorëzojë një arkivë të plotë të të gjitha materialeve të prodhuara, përfshirë file-t burimore të editueshme (p.sh. Adobe Illustrator, InDesign, Photoshop ose formate ekuivalente) në USB or CD.

#### 4. LOGJISTIKA DHE AFATET

Vendndodhja: Shqipëri

Kohëzgjatja: Kohëzgjatja e përgjithshme e kontratës do të jetë dymbëdhjetë (12) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kontraktori do të ofrojë në mënyrë të vazhdueshme shërbime komunikimi dhe dizajni grafik gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Prodhimi dhe dorëzimi i materialeve të komunikimit dhe promovimit sipas aneksit 2 do të realizohen brenda një periudhe maksimale prej tredhjetë (30) ditësh nga miratimi i koncepteve të propozuara të dizajnit dhe materialeve vizuale nga Autoriteti Kontraktor.

#### 5. KËRKESAT

### 5.1 Personeli

Kontraktori duhet të sigurojë të paktën 1 ekspertë kyç në komunikim, dizajn grafik ose fushë të ngjashme, me minimumi 3 vite eksperiencë profesionale përkatëse.

1. Diplomë (Dizajn grafik ose fushë e ngjashme)
2. CV
3. Portofol

### 5.2 Eksperienca profesionale

Kontraktori duhet të dëshmojë eksperiencë në angazhime të ngjashme që lidhen me komunikimin, dizajnin grafik dhe/ose prodhimin e materialeve ndërgjegjësuese.

## 6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Kontraktori duhet :

- Dizajnojë materiale grafike duke përdorur programe profesionale dizajni (p.sh. Adobe Creative Suite ose ekuivalent);
- Ofrojë mbështetje të vazhdueshme për dizajn grafik dhe komunikim gjatë implementimit të aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuese përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës;
- Koordinojë dhe mbikëqyrë procesin e prodhimit, përfshirë kontrollin e provave dhe kontrollin e cilësisë;
- Sigurojë dorëzimin në kohë të të gjitha materialeve;

Kontraktori duhet të koordinohet ngushtësisht me Autoritetin Kontraktor dhe të ofrojë përditësime të rregullta mbi progresin, produktet e dorëzuara dhe afatet e implementimit, sipas kërkesës.

Monitorimi do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor bazuar në cilësinë, qëndrueshmërinë dhe dorëzimin në kohë të produkteve. Kontraktori duhet të paraqesë konceptet e propozuara të dizajnit dhe materialet vizuale pranë Autoritetit Kontraktor për shqyrtim brenda një (1) muaj nga lidhja e kontratës. Prodhimi i materialeve mund të fillojë vetëm pas marrjes së miratimit formal nga Autoriteti Kontraktor.

## 7. DISPOZITA SHITESË

Kontraktori duhet të sigurojë fleksibilitet dhe disponueshmëri gjatë gjithë periudhës së kontratës për t'iu përgjigjur nevojave të vazhdueshme të projektit ne përputhje me Termat e Referencës.

## 8. MODALITETET E PAGESËS

Modalitetet e pagesës për prodhimin dhe dorëzimin e mallrave të kërkuara do të jenë si më poshtë:

- Njëqind për qind (100%) e vlerës së kontratës që lidhet me prodhimin dhe dorëzimin e mallrave të kërkuara do të paguhet pas dorëzimit të plotë dhe pranimit formal të të gjitha mallrave nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat kontraktore të miratuara.

Pagesat për shërbimet e ekspertit të dizajnit grafik do të kryhen në dy këste, si më poshtë:

- Pesëdhjetë për qind (50%) e vlerës totale të kontratës do të paguhet pas përfundimit dhe miratimit të fazës fillestare të dizajnit, përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e koncepteve vizuale, dizajneve grafike dhe materialeve përkatëse, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të miratuara nga Autoriteti Kontraktor;
- Pesëdhjetë për qind (50%) e mbetur do të paguhet pas përfundimit të plotë të shërbimeve, bazuar në detyrat e përcaktuara në Termat e Referencës (TOR), sipas nevojave që lindin gjatë implementimit të projektit dhe pas pranimit formal të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktor.